



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. *4626*/2026
Data: 19.05.2026

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e katër -IV-për vitin 2026 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 28.04.2026 me fillim pune në ora 14:30 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Vaid Daci** (Zyrtar i Kadastrit), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim me Zyrtaren e Zyrës për barazi gjinore.
3. Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale.
4. Eventuale.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Zyrtaren e Zyrës për barazi gjinore.

Kryesuesi thekson: zyrtarja për barazi gjinore nuk është prezentë por ka njoftuar që nuk mundet të merr pjesë dhe ka kërkuar që kjo pikë të diskutohet për mbledhjen e radhës.

3. Takim me Zyrtarin e Zyrës Kadastrale.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vaid Daci thekson: si zyre kadastrale operojmë në kuadër të drejtorisë së kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit. Sipas takimeve të cilat i kemi pasur me agjensionin kadastralë prej këtij viti planifikohet që të ndahemi prej komunës dhe me mbetur nën mbikëqyrjen e agjensisë kadastrale. Sy zyre nuk kemi ndonjë planifikim të veçantë por në bazë të kërkesave dhe punëve të cilat i kemi pasur, si bashkim të parcelave, ndarje dhe regjistrim pra do të thotë se janë shumë aktivitete por varet prej kërkesave të qytetarëve. Kërkesat janë kryer sipas procedurave ligjore. Diçka të veçantë nuk kam për me shtuar por nëse keni pyetje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson: sipas kësaj që potencove të hyrat të cilat inkasohen atëherë po i dedikojkan në agjensionë dhe si komuna pasmi pak humbje të buxhetit.

Sead Vila thekson: nëse një shtëpi ka qenë e banueshme por tash nuk banon askush aty, a e ka të njëjtë taksë të tatimit në pronë. Nëse ndërtohet ndonjë shtëpi në zonat rurale a vlejnjë procedurat e njëjta të regjistrimit të marrjes së lejes.

Vaid Daci thekson: çështja e tatimit në pronë është departamenti i tatimit në pronë në kuadër të drejtorisë së financave që mund të ju shpjegon më në detaje. Ndërtimi i shtëpisë në zonën rurale pavarësisht se nëse është edhe prona e jote i ka specifikat e veta për shkak se në bazë të planit zhvillimorë janë të destinuara pronat. Nëse një pronë është e destinuar për bujqësi nuk mundesh me ndërtuar shtëpi por mund të ndërtosh ashtu siç e parashih plani zhvillimorë. Kohët e fundit është duke u bërë rindërtimi kadastrit në zonën e Rezhancës dhe Pustenikut është mirë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë se është pa pagesë legalizimi i parcelave, ndarja e pronësisë, trashëgimia të cilat janë të përfshira në procesin e rindërtimit dhe janë pa pagesë.

Kryesuesi thekson: i rekomandojmë drejtorisë së Urbanizmit, Kadstrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që me sensibilizuar çështjen e legalizimit të objekteve. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6.Eventuale

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk keni shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në 15:02.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

